



DEPARTAMENTI I EPIDEMIOLOGJISË DHE KONTROLLIT TË
SËMUNDJEVE INFEKTIVE

BULETINI MUJOR I
SËMUNDSHMËRISË
INFEKTIVE
(Pasqyra 14 Sh)

SHKURT, 2024

Buletini Mujoy i Sëmundshmërisë Infektive publikohet çdo muaj nga “Sektori i Survejancës dhe Shërbimi i Inteligjencës Epidemike”, Instituti i Shëndetit Publik (ISHP). Ky Buletin Mujoy bazohet në të dhënat e Sistemit Madhor të Bazuar në Sëmundje (SMBS), të raportuara përmes Pasqyrës Mujoye 14 Sh dhe Sistemit të Informacionit të Sëmundjeve Infektive (SISI). Ai plotësohet në Pasqyrë në formatin EXCEL, dhe dërgohet me postë elektronike dhe me postë zyrtare, brenda datës 10 të çdo muaji, në Departamentin e Epidemiologjisë dhe Kontrollit të Sëmundjeve Infektive (DEKSI), Instituti i Shëndetit Publik. Të dhënat e agreguara të Pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat individuale të raportuara në SISI për muajin Shkurt 2024 janë të dhënat e raportuara nga Njësitë Vendore të Kujdesit Shëndetësor (NJVKSH). Të dhënat e pasqyrës 14 Sh dhe të dhënat e raportuara në SISI krahasohen nga DEKSI, dhe plotësohen edhe me të dhënat e laboratorëve të referencës në ISHP.

1. Sëmundjet diarreike

Sëmundjet diarreike, gjatë muajit shkurt 2024 zënë 17.5 % të totalit të sëmundjeve infektive të raportuara me anë të Pasqyrës 14 Sh, dhe paraqesin një incidencë 158.1/100.000 banorë. Gastro-enteritet e paspecifikuara janë të shpërndara në të gjitha bashkitë e vendit dhe zënë peshën kryesore në grupin e sëmundjeve diarreike. Ndërkohë që, në nivel kombëtar helmimet ushqimore paraqesin një incidencë 3.5/100.000 banorë. NJVKSH Berat dhe Kukës mbajnë peshën kryesore në raportimin e helmimeve ushqimore. Duhet theksuar që, numri i lartë i rasteve të raportuara me helmime ushqimore dhe gastro-enterite është i lidhur me pamundësinë në nivelin e disa bashkive të diagnozës së saktë klinike dhe konfirmimit të saj me diagnozën

laboratorike mikrobiologjike. NJVKSH Shkodër mban peshën kryesore të incidencës së Salmonelozës dhe Shigelozës për muajin shkurt 2024 në nivel kombëtar.


Tabela 1: Frekuencat dhe incidencat e sëmundjeve diarreike për muajin shkurt 2024
(Incidenca raste/100.000 banorë)

	Raste shkurt 2024	Incidenca shkurt 2024 (raste/100.000 banorë)
Tifo abdominale + Paratifo	0	0.00
Salmoneloza	11	0.38
Shigelozë (Disenteri bacilare)	12	0.4
Dizenteri amebike	0	0.0
Toksiko-infeksione alimentare	101	3.5
Gastro-enterite (etiologji e panjohur)	4401	153.8
Sëmundje diarreike në total	4525	158.1

2. Sëmundjet që parandalohen nga vaksina
2.1 Variçela

Në raportimin mujor të sëmundshmërisë infektive gjatë muajit shkurt 2024 janë raportuar në total 171 raste variçelë (incidenca 5.97/ 100.000 banorë) nga të cilat, 55 raste janë të dyshuara dhe 116 të konfirmuara klinikisht, bazuar kjo në përkufizimin e rastit për sëmundjen varicelë. Numri më i madh i rasteve është raportuar nga NJVKSH Tiranë me 103 raste. Numri më i lartë i rasteve i përket grup-moshës 1-4 vjeç me 64 raste, grafiku 1.


Grafiku 1. Shpërndarja e rasteve sipas grup-moshës, shkurt 2024



2.2 Fruthi


Gjatë muajit shkurt janë raportuar 75 raste si të dyshuar me fruth nga të cilat janë konfirmuar 17 (23%) raste nga ana laboratorike. Incidenca e sëmundjes për muajin shkurt është 0.6 raste/100 000 banorë.

Grafiku 2. Shpërndarja e rasteve të konfirmuara me fruth dhe incidencë sipa muajve në vitin 2024




Vërehet një trend i qëndrueshëm në dy muajt e parë të vitit 2024.

Grafiku 3. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas javës së shtrimit/vizitës te mjeku



Vërehet se gjatë muajit shkurt pjesa më e madhe e rasteve nuk kanë qenë të shtruar, por janë ndjekur në kushte shtëpie (14 raste ose 82%).

Grafiku 4. Shpërndarja e rasteve të konfirmuar sipas grup-moshës (%)



Përqindjen më të lartë e kanë grup-moshat 5-9 vjeç me 29 % të rasteve të konfirmuara.


Tabela 1. Rastet e konfirmuara sipas bashkive

Bashkia	Raste	%/totalit
Kuçovë	1	5.90%
Shkodër	2	11.80%
Tiranë	14	82.40%
Total	17	100.00%

Rastet i përkasin më tepër bashkisë Tiranë me 82.4 % të totalit.

Nga 17 rastet, 6 raste janë të pavaksinuar (35.3%), 2 raste të vaksinuar me një dozë vaksine (11.7%), 9 raste me dy doza vaksine (53%) grafikun 5.

Grafiku 5. Statusi i vaksinimit në rastet e konfirmuar



Vaksinimi i rasteve është verifikuar në të dhënat e kartelave të vaksinimit (SIV).

2.3 Pertusis


Në muajin shkurt janë raportuar 23 raste të konfirmuar me Pertusis nga NJVKSH Tiranë. Incidenca e Pertusis në muajin shkurt është 0.8 raste/100 000 banorë në vend. Moshë mediane e rasteve është 10 vjeç që varion nga 0-16 vjeç. Nga shenjat klinike mbizotëron kollë e shpeshtë dhe me aksese mbytëse të shkurtëra dhe temperaturë. Shumica e rasteve janë të vaksinuar sipas kalendarit kombëtar të vaksinimit, ku vetëm dy raste janë vaksinuar me Heaxaxim. Për çdo rast është kryer hetimi epidemiologjik dhe evidentimi i kontakteve nga NJVKSH Tiranë. Dy raste kanë transmetim familjar, dy raste kanë transmetim në shkollë, ndërsa rastet e tjera kanë transmetim komunitar.

3. Hepatitet virale

Hepatit viral B (HBV)

Në muajin shkurt janë raportuar 4 raste të konfirmuar me HBV. Incidenca e HBV në muajin shkurt është 0.2 raste/100 000 banorë në vend.

Grafiku 6. Numri i rasteve të reja me HBV dhe incidencë (raste/100 000 banorë) sipas muajve



Të gjitha rastet në muajin shkurt i përkasin grup-moshës adulte nga 35-59 vjeç, janë banorë nga bashkia Dibër dhe kanë shfaqur shenja klinike të HBV.


Hepatiti viral C (HCV)

Në muajin shkurt është raportuar 1 rast i konfirmuar me HCV i moshës 74 vjeç, mashkull nga Bulqiza. Për rastin është kryer hetimi dhe është ndjekur nga mjekët specialistë. Incidenca e HCV në nivel kombëtar për muajin shkurt është 0.04 raste/100 000 banorë.

4. Sëmundje seksualisht të transmetueshme dhe HIV/AIDS

Gjatë muajit shkurt 2024 janë kryer 30 ekzaminime për HIV (19 meshkuj dhe 11 femra) prej të cilave 11 raste (7 meshkuj dhe 4 femra) kanë rezultuar HIV pozitiv .

Grafiku 7. Shpërndarja e testimeve dhe rasteve të konfirmuara sipas gjinisë



Shpërndarja gjeografike e rasteve që kanë rezultuar HIV pozitiv është: 8 raste në Tiranë, 1 rast në Vlorë, 1 rast në Pogradec dhe 1 rast në Mirditë.

Për sa i përket shpërndarjes sipas grup-moshave: 1 rast i përket grup-moshës 16-24 vjeç, 4 raste i përket grup-moshës 25-34 vjeç, 4 raste i përket grup-moshës 35-44 vjeç, 1 rast i përket grup-moshës 45-54 vjeç dhe 1 rast i përket grup-moshës 55-64 vjeç.

Rastet e konfirmuara kanë ardhur 3 raste nga QSUT (Shërbimi Infektiv), 5 raste vijnë nga laboratorë/spitale privat (2 raste- INTERMEDICA, 1 rast nga GENIUS, 1 rast nga Klinika Kristi në Korçë dhe 1 rast nga spitali Vila Maria), 1 rast është paraqitur si vullnetar, 1 rast nga banka e gjakut dhe 1 rast i përket ndjekjes epidemiologjike .

Gjatë muajit shkurt 2024 janë raportuar 3 raste të konfirmuar Sifiliz , 2 raste janë nga Tirana dhe një nga Lezha.

5. Tuberkulozi pulmonar dhe ekstrapulmonar

Gjatë muajit shkurt 2024 janë raportuar gjithsej 17 raste (TB) pulmonar. Rastet e raportuara me TB pulmonar janë të konfirmuara dhe me sputum pozitiv. Rastet pulmonare përkatësisht janë: 7 në Tiranë, 2 në Durrës, 3 në Shkodër, 1 në Lezhë, 1 në Vlorë, 1 në Korçë, 1 në Mirditë, 1 në Pukë. Konfirmimet e tyre janë kryer në Laboratorin e Referencës të rekomanduara nga dispanseria e rrethit përkatës. Për të gjitha rastet janë lajmëruar dispanseritë përkatëse për të komunikuar me familjarët e tyre, si dhe për të kryer kontrollin në vatër bazuar në të gjitha ekzaminimet për depistimin e tyre. Të gjithë pacientët kanë filluar mjekimin sipas skemës përkatëse.

6. Sëmundjet zoonotike

Tabela 5: Shpërndarja e zoonozave në muajin shkurt 2024, numri total i rasteve dhe incidenca (Antraks, Brucelozë, Leptospirozë, Rikecie).

	Shkurt(Raste 2024)	Incidenca (raste/100,000) 2024
Antraks (Plasje)	1	0.03
Brucelozë	1	0.03
Leptospirozë	2	0.07
Rikecie	1	0.03


Për muajin shkurt është raportuar 1 rast i konfirmuar me Antraks nga NJVKSH Gjirokastrë, 2 raste të konfirmuar me Leptospirozë nga NJVKSH Sarandë dhe 1 rast Rikecioze nga NJVKSH Librazhd, dhe një rast Bruceloze nga NJVKSH Sarandë.

7 Sëmundje infektive me transmetim përmes ajrit

7.1 COVID-19


Gjatë muajit shkurt 2024 janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 89 raste të konfirmuara me COVID-19 dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin shkurt është 3.11 raste /100000 banorë.

Grafiku 8. Shpërndarja e incidencës sipas grup-moshave



Grup-mosha më e prekur për këtë muaj është grup-mosha 65-74 vjeç me incidencë 8.15 raste për 100000 banorë e ndjekur nga grup-mosha 75+ vjeç me incidencë 4.82 raste për 100000 banorë.

Grafiku 9. Shpërndarja e incidencës sipas bashkive




Bashkitë me incidencë më të lartë janë Përmet, Himarë, Kuçovë etj.
Gjatë muajit shkurt 2024 janë raportuar 11 raste të shtruara në spital dhe asnjë rast vdekjeje.

7.2 Grip

Gjatë muajit shkurt janë raportuar në Sistemin e Informacionit të Sëmundjeve Infektive 500 raste të konfirmuara me Grip, dhe incidenca e kësaj sëmundjeje për muajin shkurt është 17.4 raste /100000 banorë. Grafiku 10 tregon shpërndarjen e rasteve sipas tipit të viruseve qarkullues. Vërehet mbizotërim i Gripit Tipi A.

Grafiku 10. Tipi i viruseve qarkulluese



Në muajin shkurt qarkullimi i gripit arriti intensitet mesatar duke paraqitur aktivitet sezonal normal të zakonshëm dhe të pritshëm për stinën. Raste me grip u identifikuan si nga survejanca sentinel ILI-SARI, ashtu edhe nga survejanca virologjike josentinel.

INSTITUTI I
SHËNDETIT
PUBLIK

DEKSI